



PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 16.08.2024 në Shkollën Fillore "Veli Ballazhi" në fshatin Gorancë. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 11:00 prezent ishin 15 qytetarë. Prezent ishte Kryetari i Komunës z. Mehmet Ballazhi.

Takimin e kryesoj Drejtoresha për Buxhet dhe Financa znj. **Lindita Ballazhi**.

Rendi i Punës

1. Projekt Buxheti për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027.

Lindita Ballazhi para se me vazhduar me prezantimin e buxhetit fillimisht kërkoj nga Kryetari i Komunës për një fjalë përshëndetëse, pastaj do të bëjë prezantimin e buxhetit.

Mehmet Ballazhi është obligim ligjorë që të organizojmë dëgjim buxhetorë për planifikimin buxhetorë për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027. Pra sot shpалosim gjithçka që kemi në plan për me investuar për vitin 2025 pra është orientim se ku janë paraprë mjetet financiare për me u shpenzuar. Pavarësisht dëshirat që i kemi ne duhet të shkojmë sipas planifikimeve edhe pse kërkesat janë të shumta por ne duhet t'i shkojmë mundësitë buxhetore për projektet më prioritare dhe më të domosdoshme .

Lindita Ballazhi Buxheti paraqet një instrument financiar apo një plan njëvjeçar për ecurinë e të hyrave dhe shpenzimeve vjetore të Organizatës Buxhetore. Fazat nëpër të cilat i kemi kaluar deri në hartimin e buxhetit janë:

- Themelimi i 2 grupeve punuese: Grup punues për hartimin e dëgjimeve buxhetore dhe Grupi punues për hartimin e KAB-it 2025-2027.
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 01/2025 me kufijtë fillestar buxhetor,
- Hartimi i KAB-it me grupin punues,
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore për KAB 2025-2027,
- Miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal,
- Dorëzimi i KAB-it në Departamentin e Buxhetit - MFPT,
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 02/2025 me kufijtë final buxhetor,
- Hartimi i Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Mbajtja e Dëgjimeve Buxhetore për Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Dorëzimi i Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 para datës 01.09.2024 në Kuvend Komunal,
- Miratimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 në Kuvend Komunal,
- Dorëzimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 në Departamentin e Buxhetit - MFPT.

Buxheti për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €, ky buxhet është ndarë në kategoritë buxhetore. Për paga dhe shtesa buxheti i planifikuar është në shumë prej 2,188,542.00€, mallra dhe shërbime 584,500.00€, shpenzime komunale 94,000.00€, subvencione dhe transfere në shumë prej 143,000.00€, investime kapitale 605,415.00€. Sa i përket listës së projekteve kapitale, i kemi listuar të gjitha projektet të cilat janë miratuar nga Asambleja Komunale në KAB 2025-2027, po ne jemi të hapur edhe për propozime të reja. Më pas do të hartojmë Listën e propozimeve të qytetarëve dhe të njëjtën listë do ta dorëzojmë së bashku me Buxhetin në Kuvend Komunal për shqyrtim dhe aprovim të mëtutjeshëm.

Shefket Lusnjani për planifikimin për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027 kemi këto propozime: Hapja e rrugës baj pas , rruga Gorancë –Krivenik, rrugicat të cilat janë ende të pa shtruara, rregullimi i stazave Brenda varrezave të fshatit, te vendi i quajtur te pishat të sigurohet rryma dhe një vece publike, rregullimi i stazës për biciklistë te vendi i quajtur te pishat, shtrimi i rrugës me kupëza betoni te varrezat e fshatit Rezhancë, rregullimi i pusetave të kanalizimeve.

Nustret Kaloshi propozoj që të vendosen polic të shtrirë në rrugë për shkak të shpejtësisë që po vozisin.

Lindita Ballazhi a keni edhe ndonjë propozim përveç këtyre propozimeve , nëse nuk ka propozimet që u parashtruan do t'i analizojmë si ekzekutiv dhe do t'i përcjellim për Kuvend.

Debati përfundoi në ora 11:46.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Drejtoresh për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

